



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1747 Prot.

Tiranë, më 02.06.2025

V E N D I M

Nr. 30 datë. 02.06.2025

**“PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ROZETA MEMO NË VENDIN
VAKANT PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I
LARTË I DREJTËSISË MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi – Kryetar
Znj. Lindita Ziguri – Anëtar
Znj. Joana Sorraj- Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Amanta Jasa
Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Zonje Shelqizi

Në mbledhjen e datës 29.05.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Znj. Rozeta Memo

OBJEKTI: Urdhërimi i ndalimit të znj. Rozeta Memo, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74 datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit".
4. Znj. Rozeta Memo, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 1760 prot., datë 25.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve

dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 08.07.2024, kandidati Rozeta Memo, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 18.07.2024 kandidati Rozeta Memo ka depozituar tek sekretariati teknik, formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën përcjellëse me nr. 2230 prot. datë 03.08.2024, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ligjit nr.9367 date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar
9. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Rozeta Memo, ku deklarohet se është pajisur me kredencialet dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të

Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit" për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

10. Kandidati Rozeta Memo e ka përmbushur detyrimin për të plotësuar në sistemin EACID dhe dorëzuar si elektronikisht dhe fizikisht të plotësuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
11. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 202/23 prot., datë 16.12.2024 dhe nr. 202/24 prot., datë 10.02.2025, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë së Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidati Rozeta Memo dhe personat e lidhur me të.
12. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ILDKPKI kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidati Rozeta Memo dhe personave të lidhur me të si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimi të kriterit të pasurisë.
13. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidati Rozeta Memo, referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezultojnë se ILDKPKI me shkresën nr. 202 prot., datë 07.08.2024, i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin Rozeta Memo institucioneve bankare: *Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen sha, Banka Kombëtare Tregtare sha, Banka Intesa Sanpaolo sha,, Banka Tirana sha, Banka e Bashkuar e Shqipërisë sha, Banka ProCredit sha, Banka e Parë e Investimeve sha, Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka Credins sha, Banka Union sha, Banka OTP Albania sha, Raiffeisen Leasing sha, Porsche Leasing sha, RFZ Invest sha, Credins Invest sha, DPSHTRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.*
14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e

kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", kandidati Rozeta Memo ka depozituar diplomën nr. 9843 datën 29.06.2005 të arsimit të lartë lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist".

15. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Rozeta Memo, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 2237 prot, datë 03.08.2024*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 2236 prot, datë 03.08.2024*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 2239 prot, datë 03.08.2024*) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.2233 prot, datë 03.08.2024*).
16. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht (*me shkresën nr. 4876 prot., datë 12.09.2024, shkresën nr. 3158/1 prot., datë 26.08.2024, shkresën nr. 5780/1 prot., datë 22.08.2024 dhe shkresën nr. 1025/1 prot., datë 12.08.2024*).
17. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 2234 prot., datë 03.08.2024, është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke verifikuar mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të Kreut III dhe në zbatim të pikës 2, germa "b" Kreu V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Gjithashtu, në zbatim të kriterit të përcaktuar në pikën 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit znj. Memo, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2235 prot., datë 03.08.2024, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me verifikimin nëse ndaj kandidatit janë zhvilluar procese gjyqësore të karakterit penal, dhe rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore.
18. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 8904/1 prot., datë 14.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 2220 port., datë 03.08.2024, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror me shkresën nr. 2232 prot., datë 03.08.2024 dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier me shkresën nr. 2220/4 prot., datë 22.10.2024, dhe Bashkisë Fier nr. 2220/1 prot., datë 03.08.2024 në lidhje me periudhën e punësimit pranë këtyre institucioneve dhe periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Fier ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3968/1, prot., datë 13.08.2024, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8503/1 prot, datë 09.08.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. 8294/1 prot, datë 20.08.2024 dhe me shkresën nr. 8449/1 prot., datë 23.08.2024, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier me shkresën nr. 12098/1 prot., datë 13.11.2024, Bashkia Fier me shkresën nr. 8186/1 prot., datë 12.08.2024.
20. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, u vlerësua t'i drejtohem me kërkesë për informacion Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë me nr. 2238 prot., datë 03.08.2024. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë është përgjigjur me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024, informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit.
21. Gjithashtu, lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209, pika 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është dërguar shkresa nr. 2235, datë 03.08.2024 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku është kërkuar informacion nëse kandidati është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024.
22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse secili kandidat,

përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "e) *ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991*" apo në njërin nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Me shkresën nr. 2231 prot, datë 03.08.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1312/3 prot, datë 20.08.2024 ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (Vendim nr. 501, datë 20.08.2024 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).
24. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhet me integritetin e kandidatëve për inspektor jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, gjerat "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", është njoftuar zyrtarisht secili kandidat që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:
- mospasjen e funksioneve politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
 - mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
 - mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Për sa i takon kandidatit Rozeta Memo, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

25. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm.
26. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të C, të Kreut IV vendimit nr. 536, datë

25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 29.05.2025, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e aplikimit të kandidimit të znj. Rozeta Memo, për vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

27. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë nga aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Rozeta Memo për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
28. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana ILDKPKI-së, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 202/23 prot., datë 16.12.2024, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin Rozeta Memo dhe personat e lidhur me të.
29. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Rozeta Memo, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:
- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;**
 - b) **ka mungesë dokumentacioni të pjesshëm justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e b/shortit;**
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) nuk ka kryer deklarin të remë;
 - e) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
30. Sikurse rezulton nga akti i përfundimit të kontrollit të pasurisë me nr. 202/23 prot., datë 16.12.2024, për kandidatin Rozeta Memo, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së, sa i

takon plotësimin të kriterin e pasurisë ka probleme me kriterin e pasurisë në dy aspekte që lidhen me deklarim jo të saktë në përputhje me ligjin dhe mungesës së dokumentacionit të pjesshëm justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e b/shortit.

31. Bazuar në përgjigjen e dhënë nga ILDKPKI me aktin nr. 202/23 prot., datë 16.12.2024, Komiteti ka vendosur me shkresën nr. 3340, datë 24.12.2024, që t'i përcillen zyrtarisht kandidatit Rozeta Memo, rezultatet e kontrollit të pasurisë për sa më sipër duke i lënë një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për të dhënë sqarime dhe dokumentacion shtesë, me qëllim për të kundërshtuar gjetjet e ILDKPKI. Njoftimi i rezultatit të kontrollit të pasurisë i është njoftuar kandidatit Rozeta Memo me e-mail datë 24.12.2024, i cili administrohet në dosjen e aplikimit të kandidatit.
32. Me shkresën nr. 3340/1, datë 06.01.2025 kandidati Rozeta Memo dorëzoi në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacion sqarues në lidhje me të dhënat pronësore që kanë të bëjnë me kriterin e pasurisë, në formën e llogarive bankare, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat sipas kandidatit janë deklaruar konform ligjit dhe nuk ka asnjë parregullsi, duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shoqërues.
33. Në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2230/24 prot., datë 23.01.2025, ju drejtua sërish ILDKPKI-së, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Rozeta Memo, duke i përcjellë këtij institucioni sqarimet dhe dokumentet shoqëruese të znj. Rozeta Memo.
34. ILDKPKI me shkresën nr. 2798/18, datë 10.02.2025 ka përcjellë aktin nr. 202/24, datë 10.02.2025 mbi përfundimin e kontrollit të pasurisë. Bazuar në aktin 202/24, datë 01.02.2025 ILDKPKI-ja, mbas rivlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga ILD, rezulton se kandidati Rozeta Memo, ka probleme me kriterin e pasurisë në dy aspekte që lidhen me deklarim jo të saktë në përputhje me ligjin dhe mungesë dokumentacioni të pjesshëm justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e b/shortit.
35. Mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës për verifikimin e kontrollit të pasurisë dhe interesave financiarë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuar nga ILDKPKI-ja janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Rozeta Memo.
36. Komiteti vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Inspektor Jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t'u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Komiteti. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të

përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Rozeta Memo është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimit të kriterit të pasurisë të përcaktuar në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".

37. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Rozeta Memo nuk ka "kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". **Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket kriterit të verifikimit të pasurisë.**

38. Bazuar në sa argumentuam më sipër, nuk mund të vijohet me analizën e kriterëve të tjera, por duhet të procedohet me ndalim mbështetur në parashikimet e pikës 28 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".

39. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jo magjistrat, Komiteti vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Rozeta Memo në vendin vakant për Inspektor Jo magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikave 27 "b", 28 "b", 30, 31, 72, 73, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve

ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Rozeta Memo, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Rozeta Memo.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

KRYETAR

ANËTAR

Lindita Ziguri

Elena Pelushi

Joana Sorraj

